

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

C.nr.2884/18

PADITËSI: Mejdî Bektashi, Rr. Anton Çeta nr.14, 10000 Prishtinë, Kosovë

E PADITURA: OJQ Admovere, me numër të regjistrimit 5200390-3 dhe numër fiskal 601770119, me adresë në Rr. Ulpianë C15, Hyrja 10, nr. 6, 10000 Prishtinë, Kosovë, e përfaqësuar nga Avokatja Rina Kika, me adresë në Rr. Miss Edith Durham B1 Hyrja 1 Nr. 11, 10000 Prishtinë, (sipas Autorizimit të bashkëngjitur)

Data: 13.10.2018

Lënda : Padi për shpifje me propozim për lëshimin e masës së sigurisë

PËRGJIGJE NË PROPOZIMIN PËR
CAKTIMIN E MASËS SË SIGURISË

1. E Paditura e ka pranuar Padinë për shpifje me propozim për lëshimin e masës së sigurisë më datë 05.10.2018 dhe paraqet këtë përgjigje brenda afatit të lejueshëm në pajtim me nenin 307, paragrafi 2 i Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në vazhdim “LPK”).

Baza faktike

2. Padiësi, në padinë me të cilën i është drejtuar gjykatës ka pohuar se e Paditura ka shpifur kundër Padiësit në raportin “**Stafi Akademik i UP-së – studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerëimet e profesorëve dhe përpjesa staf-studentë e student-hapësirë**” (në vazhdim “**Raporti**”).¹

3. Raporti i publikuar ka pasur për qëllim radhitjen e të gjitha rasteve të plagjiaturës së pjesëtarëve të stafit akademik të UP-së, **për të cilat është raportuar në media përgjatë viteve, që nga vetë themelimi i UP-së**. Rasti i parë i publikuar në media ishte ai i profesorit të Fakultetit të Filozofisë, Ali Dida, në vitin 1985, e rastet e fundit ishin të vitit 2016, i profesoreshës Drita Konxheli nga Fakulteti i Ekonomisë dhe i profesorit Selim Bezeraç nga Fakulteti i Filozofisë.

¹ Admovere, *Stafi Akademik i UP-së – studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerëimet dhe përpjesa staf-studentë*, 2018, <http://admovere.org/stafi-akademik-i-up-se/>.

4. Njëri ndër profesorët për të cilin është raportuar në media për plagjiaturë është edhe Padiçesi. Rasti i tij është prezantuar në raport si vijon:

“RASTI: MEJDI BEKTASHI

Në shkurt 2007 Gazeta «Express» boton një artikull me titull «Shumë plagjiaturë» për librin «Ekonomia» të autorëve Mejdi Bektashi e Nysret Gacaferri. Në shkrim thuhet se «pjesa më e madhe e këtij libri është shkruar duke vjedhur» nga libri i autorëve të njohur botërorë Paul Samuelson dhe William Nordhaus, i botuar 14 herë në gjuhën kroate me titull «Ekonomija». Shkrimi madje citon paragrafë të tërë të vjedhur e të përkthyer me shumë gabime. Autorët nuk kanë reaguar ndonjëherë ndaj këtyre akuzave. Ndërsa Gacaferri është pensionuar shumë vjet para se të zbulohet plagjiatura, Bektashi jo veç që vazhdon me qenë profesor në Juridik, por madje është avancuar.”²

Prova nr.1: Artikulli “Shumë Plagjiaturë” nga Gazeta “Express” i autorit Jasmin Rexhepi, i datës 4 shkurt 2007.

5. Padiçesi pretendon se me të publikuar pjesën e cituar më sipër, e Paditura ka shpifur ndaj tij sepse, sipas Padiçesit, e Paditura **e ka ditur** se në lidhje me artikullin e gazetës në vitin 2007 është zhvilluar një hetim nga profesorët në Universitet, dhe komisioni hetimor ka konstatuar se “**libri i kontestuar nuk përmbanë asnjë element të plagjiaturës**”. Në lidhje me këtë Padiçesi ka bashkëngjitur Vendimin e Rektorit të atëherëshëm, z.Enver Hasani me numër reference 1/191, i datës 10.05.2007 ku konstatohet se Libri “Ekonomia” nuk është plagjiat në kuptim të Vendimit të Senatit të Universitetit të Prishtinës Nr.112, e datës 12 janar 2007 mbi mbrojtjen e pronësisë intelektuale.

6. Vendimi i Rektorit Enver Hasani me numër reference 1/191, i datës 10.05.2007 nuk është i qasshëm në web faqen e Universitetit të Prishtinës dhe nuk është publikuar as në Gazetën Express sipas informatave që i posedon e Paditura.

7. Padiçesi e ka bashkëngjitur këtë vendimin në fjalë në padi ndërsa nuk i ka bashkëngjitur dokumentet thelbësore të cilave u referohet ky vendim si: (1) Vendimi i Senatit të Universitetit të Prishtinës nr.112, i datës 12 janar 2007 mbi mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe (2) Ekspertiza/Vendimi i Komisionit Hetues të përbërë nga Prof. Dr. Halit Halimi, Mr. Sc. Albulena Blakaj dhe Prof. Dr. Ruzhdi Ushaku.

8. Asnjëri nga këto dokumente nuk janë të qasshme në web faqen e Universitetit të Prishtinës dhe nuk janë publikuar asnjëherë në medie apo në Gazetën “Express”. Për aq sa është e informuar e Paditura, Padiçesi nuk ka reaguar ndaj këtij artikulli në asnjë kanal të komunikimit publik.

² Po aty, faqe 43.

9. E Paditura si burim kryesor për pjesën e raportit që flet për rastin e Paditësit e ka patur artikullin e datës 4 shkurt 2007 «Shumë Plagjiaturë» të botuar në Gazeta “Express”. Ky ka qenë burimi kryesor i cituar nga e Paditura në Raport. Gazeta “Express” asnjëherë nuk ka publikuar demantim/përgënjeshttrim në lidhje me këtë artikull.

10. Paditësi nuk ka paraqitur asnjë provë që vërteton se e Paditura ka qenë në dijeni për Vendimin e Rektorit. E Paditura në të gjitha rastet e plagjiaturës të publikuara në Raport për të cilat ka pasur vendime të Universitetit, të njëjtat i ka përfshirë në Raport dhe i ka cituar.

Baza juridike

1. Paditësi i ka propozuar gjykatës që në bazë të nenit 297 dhe 300 LPK të caktojë masë të sigurisë në mënyrë që (1) t’ia ndalojë të paditurve publikimin e çfarëdo lloj deklarate prononcimi, njoftimi, informacioni, raporti etj, në lidhje me Paditësin dhe (2) të urdhërojë të paditurit që t’i fshijnë të gjitha raportet dhe deklaratat e publikuara, dhe të tërheqin nga qarkullimi Raportin në tirazh prej 300 kopjesh dhe nga web faqja e mediat e shkruara, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

2. Sipas nenit 297 LPK, masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se:

- A. Propozuesi i sigurimit e bën të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij dhe
- B. Kur ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

3. E Paditura konsideron se asnjëra nga këto dy kushte nuk është plotësuar me Padinë e paraqitur dhe konsideron se propozimi për caktimin e masës së sigurisë është i pabazuar ashtu siç vërtetohet nga argumentimi në vijim.

A. Besueshmëria e ekzistimit të kërkesës apo të drejtës subjektive të paditësit

4. Kërkesa e Paditësit është që të konstatohet se i Padituri ka shpifur ndaj të Paditurit kur ka publikuar Raportin në të cilin citohet artikulli i Gazetës “Express” me titull “Shumë Plagjiaturë” i datës 4 shkurt 2007. Kërkesa e Paditësit është e pabazuar për shkak të katër arsyeve:

- i) Deklarata e cila vihet në dyshim të jetë shpifje është verifikuar nga e Paditura,
- ii) E Paditura nuk është autore e deklaratës, por vetëm e citon një deklaratë tashmë të botuar,
- iii) Deklarata gëzon mbrojtje ligjore sepse ka të bëjë me çështje të interesit publik dhe
- iv) Deklarata gëzon imunitet sepse është raportim i drejtë i një shoqate që ka për qëllim përmirësimin e arsimit.

i. Deklarata e cila vihet në dyshim të jetë shpifje është verifikuar nga e Paditura

5. Shpifja sipas nenit 3, pika b të Ligjit Nr. 02/L-65 Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (në vazhdim “**Ligji kundër shpifjes dhe fyerjes**”) konsiderohet “publikimi i një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur të dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i të cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër.”

6. E Paditura ka përdorur si burim kryesor të informacionit artikullin e botuar në Gazetën “Express” të datës 4 shkurt 2007 me titull “Shumë Plagjiaturë”. Asnjë demantim/përgënjeshtim nuk është publikuar nga Gazeta “Express” në lidhje me këtë artikull. Ndërkaq, gjatë hulumtimit të të Paditurës, nuk është gjetur Vendimi i Rektorit të cilin Paditësi e ka bashkëngjitur në padi për shkak se nuk është i qasshëm në web faqen e Universitetit të Prishtinës.

7. E Paditura ka verifikuar gjetjet e Gazetës “Express” duke e krahasuar librin “**Ekonomia**” me autor **Dr.sc. Mejdi Bektashi dhe Mr.sc. Nysret Gacaferri** i botuar në vitin 2003 në Prishtinë me librin “**Ekonomija**” me autor **Paul A. Samuelson dhe William D. Nordhaus**.³

8. Kopjet e disa nga pjesët e librit të cilat përmenden në artikull dhe janë të cituara nga e Paditura janë bashkëngjitur këtu si Prova nr.2. Aty shihet qartazi se i Padituri nuk e ka cituar librin e Paul A. Samuelson dhe William D. Nordhaus në pjesët përkatëse.

Prova nr.2: Pjesë të shkëputura nga “Ekonomia” me autor Dr.sc. Mejdi Bektashi dhe Mr.sc. Nysret Gacaferri (faqe 54, 57 dhe 58) dhe “Ekonomija” me autor Paul A. Samuelson dhe William D. Nordhaus (faqe 5, 26 dhe 27).

9. Sipas nenit 10 të Kodit të Etikës për Stafin Akademik të Universitetit të Prishtinës, përcaktohet si sjellje e papranueshme: “Shkelja e standardeve të ndershmërinë intelektuale, të tilla si sjellja e pahijshme kërkimore dhe/ose keqpërdorimi i qëllimshë i shkrimeve, hulumtimeve dhe gjetjeve të të tjerëve”.

10. ”. Më tej, Rregullorja për Masat dhe Procedurat Disiplinore ndaj Personelit Akademik të Universitetit të Prishtinës, në nenin 6, pika 1.15 përcakton si shkelje të rëndë, shkeljen e të drejtës së autorit dhe e etikës në publikimet shkencore.

ii. E Paditura nuk është autore e deklaratës, por vetëm e citon një deklaratë tashmë të botuar

³ Gazeta „Express“ e ka bazuar hulumtimin në botimin e katërbëdhjetë të librit „Ekonomija“ të vitit 1992, nga autorët Paul A. Samuelson dhe William D. Nordhaus. Këtu janë bashkëngjitur pjesë të botimit të nëntëmbëdhjetë të librit të njëjtë me titull “Economics”, i botuar në vitin 2009 nga autorët e njëjtë. Pjesët e shkëputura të këtij botimi janë identike me pjesët e cituara nga Gazeta “Express” me titull “Shumë plagjiaturë”, e datës 4 shkurt 2007.

11. Sipas nenit 11, paragrafi 1 i Ligjit kundër shpifjes dhe fyerjes përcakton kufijtë e përgjegjësisë për shpifjen dhe fyerjen si vijon:

“Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë për të cilën ai ose ajo nuk kanë qenë autor, redaktor ose botues dhe ai ose ajo nuk kishte dijeni, dhe nuk ekziston arsye të besohet, se ai ose ajo kontribuan në përhapjen e shpifjes dhe fyerjes.”

12. E Paditura ka përgjegjësi të kufizuar për citimin e artikullit “Shumë plagjiaturë” të Gazetës “Express” nga se nuk është autore, redaktore a botuese e kësaj gazete dhe nuk kanë ekzistuar arsye që të besojë se po kontribon në përhapjen e shpifjes dhe fyerjes. Gjithnjë duke pasur parasysh se artikulli dhe informatat në të nuk janë përgënjeshtuar nga autori apo nga Gazeta “Express”.

iii. Deklarata gëzon mbrojtje ligjore sepse është çështje e interesit publik

13. Sipas Nenit 7 të Ligjit kundër shpifjes dhe fyerjes, deklaratat për çështje të interesit publik gëzojnë mbrojtje ligjore si vijon:

“Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të një çështjeje me interes publik, nëse ata dëshmojnë se ishte e arsyeshme në të gjitha rrethanat për një person në pozitën e tyre të përhapë materialin me qëllim të mirë, duke marrë parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështje të interesit publik që ai të marrë në kohë informacion për çështje të tilla.”

Deklarata është çështje me interes publik

14. Plagjiatura e stafit akademik të Universitetit të Prishtinës është çështje me interes të veçantë publik ashtu siç janë edhe të gjitha çështjet që lidhen me arsimin e lartë publik në Kosovë. Universitetet publike financohen nga paratë publike të shtetit dhe për më tepër janë institucione arsimore të cilat janë me interes të veçantë shoqëror. Prandaj, e Paditura ka vepruar brenda të drejtës së saj në lirinë e shprehjes kur i ka përmbledhur rastet e plagjiaturës të raportuara në media përgjatë viteve që nga themelimi i Universitetit, përfshirë këtu edhe raportimin për rastin e Paditësit.

Qëllimi i mirë i publikimit të Raportit

15. Raporti i publikuar i ka radhitur të gjitha rastet e plagjiaturës së pjesëtarëve të stafit akademik të UP-së, për të cilat është raportuar në media përgjatë viteve, që nga vetë themelimi i UP-së. Qëllimi i këtij Raporti ishte që këto raste të plagjiaturave të publikuara në media t’u dërgohen udhëheqësve të njëjësive akademike të UP-së, por edhe Rektoratit të UP-së, në mënyrë që më pas ata të ndërmarrin masa ndaj atyre që kanë kryer plagjiaturë. Kjo do të çonte një mesazh të tjerët që plagjiatura ndëshkohet e kështu do të përmirësohej sadopak gjendja në UP.

16. Një prej arsyeve pse e Paditura ka vendosur t’i përmbledhë e t’i botojë rastet e raportuara në media të plagjiaturës ka qenë edhe fakti se prej 13 dekanëve të fakulteteve të UP-

së, 10 që kanë pranuar të intervistohen për Raportin e të Paditurës, që të gjithë janë përgjegjor se nuk dinë për ndonjë rast të plagjiaturës të pjesëtarëve të stafit akademik të fakultetit që drejtojnë. Ndërkaq, nga 40 pjesëtarë të stafit akademik që janë intervistuar, 34 kanë thanë se nuk dinë dhe/ose nuk besojnë të ketë pasë ndonjë rast plagjiature.

17. Nga gjithsejt 16 pjesëtarë të stafit akademik të UP-së të cilëve u janë shpalosur plagjiaturat në media, shumica nuk kanë reaguar asnjëherë publikisht ndaj akuzave. Prej këtyre 16 rasteve, vetëm tre janë suspenduar nga procesi mësimor, mirëpo që të tre më pas janë kthyer. Vetëm njërit – që nuk ka qenë mësimdhënës i rregullt, por i angazhuar – i është ndërprerë kontrata e punës. Pra, edhe kur zbulimet e plagjiaturave të pjesëtarëve të stafit akademik janë publikuar nëpër media, plagjiatorët jo veç që nuk kanë dhënë dorëheqje, por në shumicën dërrmuese të rasteve, as që u janë nënshtruar masave. Në ato pak raste kur ndonjë masë është ndërmarrë, ajo është shfuqizuar më pas. Për më tej, shumë prej të akuzuarve për plagjiaturë edhe janë avancuar.

iv. Deklarata gëzon imunitet ligjor sepse është raportim i drejtë i një shoqate që ka për qëllim përmirësimin e arsimit

18. Deklaratat e të paditurës gëzojnë mbrojtje ligjore sipas nenit 9, paragrafit 1 të Ligjit kundër shpifjes dhe fyerjes, ku përcaktohet si vijon:

“Deklaratat e dhëna nuk bartin përgjegjësi në bazë të këtij ligji nëse i paditur dëshmon se ato janë bërë në cilën do nga rrethanat në vijim:

l) një raportim i drejtë dhe i saktë mbi konstatimet ose vendimet e një shoqate që ka formalisht kompetencën e të gjykuarit ose të kontrollit me qëllimin për të ndihmuar artin, shkencën, fenë, arsimin, (...)”

19. E Paditura angazhohet për ndërtimin e një shoqërie demokratike, promovimin e tolerancës e bashkëjetesës dhe luftimin e paragjykimëve. Një ndër fushëveprimet kryesore të së Paditurës është edukimi. Për më tepër, e Paditura është edhe anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet – KITU, i cili është një koalicion i një mori organizatash të shoqërisë civile që kanë për qëllim të përmirësojnë gjendjen e arsimit në Universitetin e Prishtinës dhe t’ia kthejnë publikut besimin në Universitet.

20. Andaj, e Paditura nuk bartë përgjegjësi për shpifje dhe fyerje për deklaratën e dhënë, ngase është organizatë që e ka formalisht kompetencën e të gjykuarit dhe kontrollit të proceseve akademike në arsimin e lartë. Ndërsa konstatimet i ka të bazuara në ndjekjen e kritereve të përcaktuara në ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Kosovës si dhe standardeve ndërkombëtare akademike.

B. Rreziku i pamundësimin apo vështirësimin të realizimit të kërkesës

Nuk ekziston rreziku i pamundësimin apo vështirësimin të realizimit të kërkesës

21. Sipas nenit 297 LPK, kusht i dytë për shqiptimin e masës siguroese është ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës siguroese e Paditura do ta pamundësonte apo vështirësonte

dukshëm realizimin e kërkesës apo ndryshimin e gjendjes ekzistuese të gjërave duke ndikuar negativisht në të drejtat e Paditësit.

22. Paditësi përveç dëmit jo-material, ka kërkuar që e Paditura të kërkojë falje publikisht për publikimin e deklaratës, që t'i fshijë të gjitha deklaratat e kaluara në lidhje me Paditësin si dhe të mos publikojë “shpifje” në të ardhmen ndaj Paditësit.

23. Ndërsa, në propozimin për caktimin e masës siguroese, Paditësi ka kërkuar që të paditurës t'i ndalohej publikimi i çfarëdo deklarate, prononcimi, njoftimi, informacioni, raporti, etj. në lidhje me të. Po ashtu, Paditësi ka kërkuar që të fshihen të gjitha deklaratat e publikuara në lidhje me Paditësin.

24. Në asnjë vend, Paditësi nuk e ka arsytuar se përse konsideron se caktimi i kësaj mase është i nevojshëm për sigurimin e kërkesës së tij. E Paditura konsideron se nuk ka asnjë arsye logjike që të mendohet se ekziston rreziku i pamundësimin apo vështirësimin të realizimit të kërkesës nga e Paditura. Përkatësisht, nuk ekziston rreziku se e Paditura nuk do ta paguante dëmin, se nuk do të kërkonte falje publikisht po të urdhërohej nga gjykata dhe nuk ekziston rreziku se e Paditura do do të vështirësonte apo pamundësonte fshirjen e deklaratave të publikuara në lidhje me Paditësin.

25. Në rastin konkret, duhet theksuar se artikulli i Gazetës “Express” nuk është përgënjeshtuar asnjëherë, që nga viti 2007. Citimi i këtij artikulli që nuk është përgënjeshtuar asnjëherë në Raport nuk mund të konsiderohet se do të shkaktonte dëm të pariparueshëm të Paditësi.

26. Sa i përket urdhërimit të ndalimit të publikimit të deklaratave, prononcimeve, njoftimeve, informacioneve, raporteve etj, në lidhje me Paditësin si dhe fshirjen e publikimeve të mëherëshme, e Paditura konsideron se kjo masë e sigurimit do të ishte cënim i drejtëpërdrejtë i lirisë së shprehjes. Përkatësisht, kjo masë e sigurisë do cënonte të drejtën e përcaktuar në nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si vijon:

“Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për tu shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.”

27. Në rastin konkret, nuk është plotësuar as kushti i dytë që kërkohet për caktimin e masës siguroese nga se nuk ekziston asnjë rrezik se e paditura do ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës nga ana e Paditësit. Po ashtu, vlen të përmendet se nuk ka asnjë arsye të mendohet se ekziston rreziku se e paditura do të ndryshojë gjendjen ekzistuese të gjërave duke ndikuar negativisht në të drejtat e Paditësit.

Përfundim

28. E Paditura konsideron se Paditësi nuk i ka plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurimit të parapara në nenin 297 LPK, sepse:

- 1) Paditësi nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij,
- 2) nuk ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë e Paditura do ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës apo do të bënte ndryshimin e gjendjes ekzistuese të gjërave duke ndikuar negativisht në të drejtat e Paditësit/propozuesit të sigurimit.

29. Aprovimi i propozimit të Paditësit për caktimin e masës së sigurisë do të binte ndesh me lirinë e shprehjes së të paditurës që është e drejtë themelore e mbrojtur me ligjet në fuqi dhe me Kushtetutën e Kosovës.

30. Rrjedhimisht, e Paditura kërkon nga gjykata që pas shqyrtimit të kësaj përgjigje kundër propozimit të caktimit të masës së sigurisë dhe provave të bashkëngjitura të nxjerrë këtë:

AKTVENDIM

- I. REFUZOHET si plotësisht e pabazuar kërkesa e Paditësit për caktimin e masës së sigurisë, me të cilën ka kërkuar që të Paditurës t'i ndalohe publikimi i çfarëdo deklarate, prononcimi, njoftimi, informacioni, raporti, etj. në lidhje me Paditësin Z.Mejdi Bektashi deri në sjelljen e aktgjykimit nga gjykata.
- II. REFUZOHET kërkesa e Paditësit që të caktohen masa e sigurisë me të cilën urdhërohet e Paditura që t'i fshijë të gjitha raportet dhe deklaratat e publikuara në lidhje me Z. Mejdi Bektashi, si dhe ta tërheqë nga qarkullimi Raportin në fjalë të shtypur në tirazh prej 300 kopjesh, të cilat janë të publikuara në media të shkruara, web faqe, faqe të internetit deri në sjelljen e aktgjykimit nga gjykata.

Përfaqësuesja e të Paditurës

(sipas autorizimit)

Av. Rina Kika

Lista e provave të bashkëngjitura

Autorizimi i Av. Rina Kika

Prova nr.1: Artikulli “Shumë plagjiaturë” nga autori Jasmin Rexhepi, Gazeta “Express”, 4 shkurt 2007.

Prova nr.2: Pjesë të shkëputura nga “Ekonomia” me autor Dr.sc. Mejdi Bektashi dhe Mr.sc. Nysret Gacaferri (faqe 54, 57 dhe 58) dhe “Ekonomija” me autor Paul A. Samuelson dhe William D. Nordhaus (faqe 5, 26 dhe 27).